



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 05, datë 08.11.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: “ZHVILLIM KOMPLEKS
PËR SHITESË KATI DHE NDRYSHIME TË AMBIENTEVE EKZISTUESE TË
HOTELERISË, NDËRTIMIN E AMBIENTEVE TË REJA PËR SHËRBIME HOTELERIE,
ZYRA DHE GODINË REZIDENCIALE” ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërive “Kastrati Residence” sh.p.k, “Kastrati Hotels & Tower” sh.p.k dhe “Mak Elite Offices” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Zhvillim kompleks për shtesë kati dhe ndryshime të ambienteve ekzistuese të hotelerisë, ndërtimin e ambienteve të reja për shërbime hotelerie, zyra dhe godinë rezidenciale”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, me zhvillues shoqëritë “Kastrati Residence” sh.p.k, “Kastrati Hotels & Tower” sh.p.k dhe “Mak Elite Offices” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, sipas fazave, si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Tiranë, për çdo fazë, bazuar në përcaktimet dhe rregullat e parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

